LIGJ
Nr. 10 264, datë 8.4.2010

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË LIGJIN NR. 7926, DATË 20.4.1995 "PËR TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 8, paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

"Anëtarët e këshillave mbikëqyrëse të shoqërive aksionare shtetërore i propozohen Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës si më poshtë:

a) 1/3 e anëtarëve propozohet nga Ministri i Financave;

b) 1/3 e anëtarëve caktohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës;

c) 1/3 e numrit të anëtarëve propozohet nga ministria e linjës administrative apo nga organi i qeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin për shoqërinë shtetërore përkatëse.

Mënyra e propozimit dhe e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse të shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve bëhet në përputhje me statutin e tyre.".

Neni 2

Ngarkohen titullarët e ministrive që preken nga ky ligj që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e tij, të bëjnë ndryshimet në këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6522, datë 28.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi